



REPUBLIKA E SHQIPERISË
MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT
AGJENCIA KOMBËTARE E MJEDISIT
DREJTORIA E LEJEVE MJEDISORE DHE VNM

AN040520230020

Tiranë, më 30.05.2023

Komisioni 60

DEKLARATË MJEDISORE

Në mbështetje të Ligjit Nr. 12/2015 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10440, datë: 07.07.2011, “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, VKM 714, datë: 06.11.2019, për disa ndryshime dhe shtesa në VKM 686, datë: 29.07.2015, “Për miratimin e rregullave, përgjegjesive e afateve, për zhvillimin e procedurës së transferimit të Vendimit e Deklaratës Mjedisore”, të ndryshuar, dhe me propozim të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, Ministri

VENDOSI:

Lëshimin e Deklaratës Mjedisore për **Zhvilluesin** me të dhënat si më poshtë:

Personi juridik: “CR-4” Sh.p.k.

Nr. NIPT-i: L46315702I

Adresa e selisë: Kraste, Sheshi Murat Zhaboli, Objekt privat me numer pasurie 1/39-N11, zona kadastrale 2267, Martanesh

Personi përgjegjës: Mersin Isaku

Për të zhvilluar projektin “**Shfrytëzim i mineralit të kromit**”

Aplikimi është bërë referuar ligjit Nr. 10 440, date: 7.7.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, Shtojca I, “Projektet që i nënshtrohen Proçedurës së Thelluar të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis”, Pika 19. Gurore dhe miniera sipërfaqësore, ku sipërfaqja e vendit është mbi 0,5 hektarë, ose vende për nxjerrjen e torfës, ku sipërfaqja e vendit është mbi 1 hektar.

Vendndodhja: Bashkia Bulqizë, Objekti “Përroi i Lopsit”, Zona Minerare Nr. 591/1, Qarku Dibër.

Të dhëna teknike:

Sipërfaqe : 1.251 km²

Lloji i mineralit: Krom

(Bashkangjitur vendimit, gjeni aneksin me hartën topografike dhe koordinatat metrike, ku tregohet vendodhja e objektit)

Bazuar në nenin 12, të ligjit nr. 10440, datë 7.7.2011, “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, i ndryshuar, i sugjerohet autoritetit planifikues:

Miratimi i lejes/licencës së zhvillimit të atij projekti, me kushtet që duhet të përmbushen nga zhvilluesi, për të parandaluar, minimizuar dhe menaxhuar ndikimet negative në mjedis;

Bazuar në pikën 2, të nenit 12, të ligjit nr. 10440, datë 7.7.2011, “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, të ndryshuar, më poshtë po listojmë:

1. Qëndrimin e Ministrisë dhe sipas rastit, kushtet që duhet të përmbushen nga zhvilluesi:

Drejtoritë Teknike të Ministrisë shprehen: • Drejtoria e Ndryshimeve Klimatike shprehet me rekomandimet si më poshtë vijon:

- Të respektohen normat e lejuara të shkarkimeve në ajër të ndotësve të gaztë dhe lëndës së ngurtë pezull, në zbatim të VKM-së nr. 435, datë 12.9.2002 “Për miratimin e normave të shkarkimeve në ajër në Republikën e Shqipërisë”;
- Të spërkaten rregullisht me ujë rrugët e transportit, për mbajtjen nën kontroll të pluhurformimit, si dhe forcimin e zbatimit të këtyre masave edhe më shumë në kohën e thatë dhe me erë, në zbatim të VKM-së nr. 412, datë 19.6.2019 “Për miratimin e planit kombëtar për menaxhimin e cilësisë së ajrit”;
- Automjetet transportuese, të mos ngarkohen më shumë së kapaciteti i tyre mbajtës, si dhe të mbulohen me struktura të posaçme, për të shmangur përhapjen e pluhurave dhe derdhjen e materialeve që transportohen, në zbatim të VKM-së nr. 412, datë 19.6.2019 “Për miratimin e planit kombëtar për menaxhimin e cilësisë së ajrit”.
- Me qëllim mbrojtjen e mjedisit, përdorimi i lëndëve plasëse, të bëhet në përputhje me Ligjin nr. 74/2021 “Për hedhjen në treg dhe mbikëqyrjen e lëndëve plasëse për përdorim civil”.
- Në zbatim të legjislacionit përkatës për fushën e ndryshimeve klimatike, sugjerohet që të kryhet rehabilitimi i plotë i sipërfaqeve të gjelbra të dëmtuara si rezultat i ushtrimit të aktivitetit.
- Drejtoria e Ekonomisë Qarkulluese sugjeron që zhvilluesi duhet të përmbushë detyrimet për menaxhimin e mbetjeve, në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi, në fushën e mbetjeve, si më poshtë vijon:
 - Gjatë aktivitetit minerar mbetjet inerte të gjeneruara të trajtohen sipas kërkesave të VKM nr. 575, datë 24.06.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”.
 - Të zbatohet Ligji nr. 10 463, date 22.09.2011 “Per menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar.
 - Të respektohen kërkesat e VKM nr. 418, date 25.06.2014 “Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim”.
 - Mbetjet që do të krijohen, të specifikohen sipas kodeve të VKM nr. 402, datë 30.06.2021 “Për miratimin e katalogut të mbetjeve”.
 - Transferimi i mbetjeve jo të rrezikshme të shoqërohet me plotësimin e shtojcës 1 të VKM nr. 229, datë 23.04.2014 “Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe të dokumentit të transferimit të mbetjeve jo të rrezikshme”, të ndryshuar.
 - Mbetjet e rrezikshme, të dorëzohen sipas VKM nr. 371, datë 11.06.2014 “Për përcaktimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe miratimin e dokumentit të dorëzimit të mbetjeve të rrezikshme”, të ndryshuar.
 - Subjekti që do të transportojë ose do të transferojë mbetjet të jetë i pajisur me licensë III.2.B, si detyrim i nenit 57, të ligjit nr. 10463, date 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”.
 - Për të gjitha mbetjet nga ambalazhet të zbatohet VKM nr. 177, datë 06.03.2012, “Për ambalazhet dhe mbetjet e tyre”, i ndryshuar.

Në veprimtarinë për të cilën aplikon subjekti, menaxhimi i mbetjeve të bëhet sipas parimit të përgjegjshmërisë ndaj mjedisit, në përputhje me VKM nr. 418, datë 27.5.2020 “Për miratimin e Dokumentit të Politikave Strategjike dhe të Planit Kombëtar për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve 2020-2035”, duke synuar uljen e sasisë së mbetjeve të gjeneruara dhe menaxhimin e integruar të mbetjeve.

• Drejtoria e Natyrës dhe e Pyjeve sugjeron si më poshtë vijon:

- Sektori i pyjeve vlerëson se për sipërfaqet pjesë e fondit pyjor kombëtar në çdo rast duhet pasur parasysh zbatimi me rigorizitet i ligjit 57/2020, datë 30.4.2020 “Për Pyjet”, veçanërisht nenin 12 të tij në konsultimin me publikun nuk ka përfaqësues të strukturës përgjegjëse për pyjet në bashki rehabilitimi duhet të jetë konkret sipas grafikut të punimeve.

- Sektori i mbrojtjes së natyrës sugjeron që subjekti gjatë zhvillimit të aktivitetit duhet ti përmbahet legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e natyrës dhe konkretisht ligjeve: Ligjin nr. 9587, datë 20.7.2006 “Për mbrojtjen e biodiversitetit” i ndryshuar; Ligjin nr.10 006, datë 23.10.2008 “Për mbrojtjen e faunës së egër” i ndryshuar, si dhe të bëjë rehabilitimin e zonës me mbjellje pemësh.

Bazuar në nenin 12, pika 1 e ligjit nr . 10440 / 2011 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis" të ndryshuar, në rast se zgjidhni pikën “a” apo “b” të referencës ligjore së sipërcituar, në Deklaratën Mjedisore të vendosen kushte të detajuara përsa i përket mbrojtjes së biodiversitetit, menaxhimit të pyjeve, emetimeve në ajër, shkarkimeve të ujrave të ndotura, menaxhimit të mbetjeve, etj. Të cilat duhet të përmbushen nga zhvilluesi, për të parandaluar, minimizuar dhe menaxhuar ndikimet negative në mjedis.

Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura shprehet: Bazuar në planvendosjen dhe koordinatat e aplikimit, sipërfaqja ku do të zhvillohet aktiviteti “Shfrytëzimi i mineralit të Kromit, Objekti “Përroi i Lopsit”, Zona Minerare Nr. 591/1, Bashkia Bulqizë, me zhvillues “CR-4” dhe aplikues “Agim Pashaj”, me nr. Aplikimi AN040520230020, nuk ndodhet brenda rrjetit të zonave të mbrojtura.

Mnistria e Infrastruktues dhe Energjisë shprehet se: Në vijim të aplikimit me Nr. AN040520230020, të depozituar në sistemin elektronik të lejeve për të cilin keni kërkuar mendim për pajisjen me Deklaratë Mjedisore për objektin: “Shfrytëzimi I Mineralit Krom, Objekti “Përroi i Lopsit”, Bulqizë, Dibër”, me Subjekt Zhvillues CR-4 amp; me vendndodhje në Bashkinë Bulqizë, Njësia Administrative Martanesh, ju bëjmë me dije si më poshtë vijon:

Shoqëria "CR-4" sh.p.k, ka aplikuar ne QKB me Nr. LC-7306-11-2022, date 22.11.2022, per shndërrimin e lejes se kerkim-zbulimit Nr.1922, date 12.07.2021, ne leje shfrytezimi per mineral kromi ne objektin "Perroi i Lopsit", Bashkia Bulqize, Qarku Diber.

Aplikimi eshte kryer ne zbatim te Udhëzimit Nr. 14, datë 17.6.2022 "Për përcaktimin e kriterëve dhe rregullave të mënyrës së aplikimit për shndërrimin e lejeve minerare". Referuar pikes B.3 te VKM Nr.942, datë 17.11.2010 "Për miratimin e procedurave dhe të dokumentacionit për marrjen e lejeve minerare në zonat e hapura", i ndryshuar, ku percaktohet se: "Ministri, brenda një afati prej 120 (njëqind e njëzet) ditësh kalendarike nga data e aplikimit në QKB, nxjerr aktin e miratimit ose të refuzimit të lejes së shfrytëzimit, kërkim-zbulim-shfrytëzimit dhe garancive financiare për realizimin e programit minimal të punës dhe realizimin e planit të rehabilitimit të zonës minerare. Brenda këtij afati subjekti duhet të pajiset me lejen përkatëse mjedisore që mbulon zonën e kërkuar minerare. Në rast të mospajisjes me këtë leje, ministri nxjerr aktin e refuzimit për pajisjen me leje minerare", per vijimin e procedures se pajisjes se subjektit me leje minerare shfrytezimi, MIE eshte ne pritje te pajisjes se subjektit me lejen perkatese mjedisore.

Agjencia Rajonale e Mjedisit Tiranë, Durrës, Dibër shprehet se implementimi i projektit te propozuar do te kete ndikim ne mjedis duke ndikur ne:

- Rritjen e erozionit te zones;
- Degradimin e bimesise (flores) se zones;
- Shqetesim te kafsheve te egra (faunes) te zones, per shkak te demtimit dhe humbjes se habitateve te tyre natyrore dhe per shkak te zhurmes se krijuar nga perdorimi i lendes plasese gjate nxjerrjes se mineraleve.

ARM Tirane, Durres, Diber sugjeron mbajtjen ne konsiderate dhe zbatimin me rigorozitet te masave te listuara me poshte per parandalimin dhe minimizimin e ndikimit ne mjedis:

- Në të gjitha rastet që do të ketë ndërhyrje në mjedis do të duhet të ruhet vegjetacioni si edhe bimësia karakteristike zonale duke mos dëmtuar në asnjë rast peizazhin natyror të zonës së marrë në studim.

- Ne rastet se gjate venies ne zbatim te projektit dhe funksionimit te tij do te verehet prania e flores dhe e faunes te cilat jane specie te rrezikuara ose endemike te tregohet kujdes i vecante per te mos e demtuar ate.

- Gjate hapjeve te rrugeve te reja subjekti te kete kujdes bimesine ne zonen ku do te nderhyje, duke pasur parasysh se ne cdo rast te prerjeve apo shkuljeve te pemeve, gjate fazes se rehabilitimit ato te zevendesohen me po te njejtat lloj I gjithe territori i shfrytezimit te rrethohet me rrjete per te parandaluar hyrjen e kafsheve te zones.

Gjithashtu sugjerojme:

- Kamionat transportues te gurit gelqeror te jene te pajisura me bordura mbrojtese dhe me mushama per te shmangur renien aksidentale te gurit dhe perhapjen e pluhurave. Te pastrohen gomate e makinave kur te dalin nga territori.

- Të zbatohen standardet dhe praktikat më të mira gjate perdorimit te lendeve plasese. Punëtorët të pajisen me kufje per mbrojtjen nga zhurma.

- Te perdoren sprucator per te shmangur perhapjen e grimcave te pluhurave si pasoje e shperthimeve per kerkimin e mineralit te kromit.

- Shfrytezimi i burimeve ujore te behet me Leje.

- Te behet trajtimi i ujerave te ndotur me grope dekantimi.

- Te parashikohen masat për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në rast aksidentesh.

- Te zbatohet orari sipas legjislacionit ne fuqi per levizjen e automjeteve, per te shmangur vibrimet dhe zhurmat ne zonat e banuara.

2. Informacion për procesin e realizuar të konsultimit me publikun:

Konsultimi me publikun: U krye në datën 25.04.2023. Morën pjesë përfaqësues nga komuniteti i zonës, përfaqësues nga Njësia Administrative Martanesh nga Drejtoria Rajonale e Mjedisit dhe ekspert mjedisi nga studio konsulente Z.Agim Pashaj. Në takim është prezantuar projekti, janë dëgjuar sugjerimet e pjesëmarrësve, të cilët shprehën dëshirën që investitori të punësojë sa në shumë banorë të zonës, të zbatojë të gjitha kushtet teknike, të kryej rehabilitimin e plotë dhe të zbatojë me rigorozitet kushtet e lejes medimore. Për komunitetin ky investim ishte i mirëpritur dhe ata u shprehën bashkëpunues për sa i përketë rritjes së punësimit dhe infrastrukturës.

3. Arsyet dhe konsideratat kryesore, ku është mbështetur mendimi;

Zhvillimi i aktivitetit është në përputhje me:

- Në mendimin e anëtarëve të Komisionit 60, datë 29.05.2023, i mbledhur në zbatim të Urdhërit nr.75, datë 07.04.2023, për “Krijimin e komisionit teknik për shqyrtimin e kërkesave që i nënshtrohen procedurës paraprake dhe të thelluar të vlerësimit të ndikimit në mjedis”;

- Vendim i Këshillit Teknik të SHGJSH Nr 136/1, datë 24.01.2023, dërguar Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë me subjektin "CR-4" sh.p.k, Objekti "Përroi I Lopsit, Bashkia Bulqizë, Qarku Dibër.
- Mendimin e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë
- Mendimin e Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura;
- Mendimin e Agjencisë Rajonale të Mjedisit.

4. Përshkrimin, sipas rastit, të masave kryesore që duhen marrë për të shmangur, reduktuar e nëse është e mundur, për të korrigjuar efektet negative të rëndësishme:

4.1 Ky objekt të ndërtohet në përputhje të plotë me Planin e Përgjithshëm Vendor dhe Planin e Detajuar Vendor, të miratuar nga organet kompetente (KKT / Bashkia / Njësi Administrative) dhe akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

4.2 Ky vendim nuk është leje zhvillimi përfundimtare për zbatimin e këtij projekti, por është një dokument i cili lëshohet me kusht që në rast se do të zhvillohet ky aktivitet, duhet të zbatohet kushtet e vendosura si detyrim që vjen nga Ligji Nr. 10431, datë 9.6.2011 "Për Mbrojtjen e Mjedisit", si dhe Ligji nr. 10 440, datë 07.07.2011 "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis", të ndryshuar, KREU I, Neni 1, Pika a); KREU II, Neni 7, Pika 1; KREU V, Neni 20, Pika 1.

4.3 Në rast se gjatë punimeve shfaqen elemente të tillë si: objekte kulturi, gjurmë arkeologjike, burime ujore etj, subjekti të ndërpresë punimet dhe të lajmërojë urgjentisht organet kompetente.

4.4 Kjo Deklaratë është e vlefshme pasi subjekti të bëjë heqjen nga Fondi Pyjor, në rast se aktiviteti bie në një të tillë. Të ketë në vëmendje të veçantë referencat kadastrale që preken nga ushtrimi i aktivitetit.

4.5 Në bazë të Ligjit Nr. 81/2017, "Për Zonat e Mbrojtura", nga zbatuesit e projektit të merren masa që mos të dëmtohen zona me status të veçantë.

Gjatë fazës së instalimit:

4.6 Të vendoset sinjalistika paralajmëruese përgjatë gjithë segmentit të punimeve me qëllim shmangien e aksidenteve njerëzore.

4.7 Të instalohet sistemi i eliminimit dhe kapjes së pluhurave, nëpërmjet sprucimit me ujë. (Ky sistem, të detajohet qartë me skica, planimetri etj në aplikimin për Leje Mjedisore)

4.8 Të kontrollohen kushtet teknike të mjeteve të punës në mënyrë periodike për të evituar, parandaluar rrjedhjet e lubrifikantëve e të hidrokarbureve në mjedis, emetimin e gazeve të shkaktuara nga avari teknike të mjeteve të subjektit.

4.9 Të respektohet distanca nga rruga, gjatë fazës së instalimit dhe kryerjes së punimeve, sipas legjisllacionit në fuqi.

4.10 Përdorimi i pajisjeve, automjetet, që emetojnë nivele zhurmash brenda normave të lejuara të emetimit 60 – 100 db.

4.11 Subjekti të realizojë në mënyrë të menjëhershme çdo ndërhyrje teknike për të riparuar çdo fenomen negativ në mjedis si pasojë e veprimtarisë së tij.

4.12 Të sistemohen brenda sipërfaqes së shfrytëzimit të gjitha sterilet e gjeneruara nga shfrytëzimi i karrierës.

4.13 Në raste aksidentesh ose defektesh teknologjike që shkaktojnë ndotje të mjedisit, subjekti menjëherë duhet të jap informacion në DRM-në e qarkut përkatës dhe AKM, të cilat bëjnë të mundur njoftimin e popullatës që preket nga ky aksident.

4.14 Subjekti të hartojë dhe zbatojë një plan masash lidhur me masat e parandalimit dhe shuarjen e zjarreve në rast aksidentesh nga plasjet për nxjerrjen e materialit.

- 4.15** Të mbillen pemë në të gjithë perimetrin e zonës për të minimizuar ndikimet në mjedis dhe përmirësuar pejsazhin.
- 4.16** Subjekti të kujdeset për menaxhimin e mbetjeve të krijuara gjatë fazës së instalimit, sidomos ato të ambalazhimit, duke i transportuar në mënyrë të rregullt në vend grumbullimit e caktura nga njësia vendore. Zotëruesit e mbetjeve inerte duhet të zbatojnë detyrimet që janë të përcaktuara në VKM nr.575, datë 24.06.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”.
- 4.17** Përgjatë gjithë rrugës së brendshme të karrierës (përfshi transhetë), të hapet një kanal ujëmbledhës i orientuar drejt një grope dekantimi, për mbledhjen dhe disiplinimin e ujërave gjatë kohës së shfrytëzimit.
- 4.18** Të bëhet pastrimi i mjeteve të punës para daljes nga kantieri i ndërtimit për të mos shkaktuar ndotje në mjedis.
- 4.19** Të merren masa për mbrojtjen e biodiversitetit të zonës.
- 4.20** **Të kihet kujdes treguesit kadastralë të sipërfaqes pyjore/kullosore që do të përdoret për aktivitetin, të jenë vetëm brënda sipërfaqes së miratuar.**
- 4.21** **Personi përgjegjës teknik për zhvillimin e aktivitetit duhet të jetë i informuar për bazën ligjore të pyjeve në fuqi dhe për zbatimin e tyre.**
- 4.22** Subjekti të respektojë kushtet lidhur me mbrojtjen e biodiversitetit, menaxhimin e pyjeve, emetimet në ajër, shkarkimet e ujërave të ndotura, menaxhimin e mbetjeve etj.
- 4.23** Subjekti të respektojë dhe të mbajë parasysh kërkesat dhe kriteret e Ligjit Nr. 81/2017 “Për Zonat e Mbrojtura”.
- 4.24** Kompania duhet të respektojë gjithashtu kushtet e vendosura në raportin e VNM-së të aplikuar si dhe Ligjin Nr. 10 431, datë 9.6.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”.
- 4.25** Në përfundim të punimeve, të rehabilitohet zona e shfrytëzuar.
- 4.26** **Duke qënë se gjatë fazës së funksionimit, ky aktivitet do të ketë efekte në mjedis, në bazë të Ligjit Ligj nr. 52/2020, datë 30.4.2020 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10 448, datë 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit”, të ndryshuar.**

5. Monitorimi dhe Raportimi

Në bazë të Ligjit Nr. 128/2020 Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 10440, datë: 07.07.2011, “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, të ndryshuar, Neni 25/1 “Monitorimi dhe vlefshmëria”, zhvilluesi ka detyrimet si më poshtë:

- Zhurma dhe Vibracionet

- Të zbatohen nivelet kufi të zhurmës, referuar Udhëzimit Nr. 8, date 27.11.2007 “Për nivelet kufi të zhurmave në mjedise të caktuara” dhe Ligjit Nr.9774 date 12.07.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”
- Të merren masa për mbrojtjen e punonjësve nga zhurmat.
- Të merren masat për kufizimin e orareve të punës në kantier.
- Operatori duhet të parandalojë gjenerimin e zhurmës impulsive në zonat e ndjeshme ndaj zhurmës, gjatë operimit të instalimeve.
- Vibrimet në vende të ndjeshme nuk duhet të kalojë 10 mm/s (PPV) në çdo kohë.
- Të bëhet monitorimi i zhurmave për mjediset: automjete/kamiona në hyrje të kantierit, kantier ndërtimi dhe mjedisi urban më i afert me kantierin çdo 6 muaj.

| Mjedisi | Vlera kufi e zhurmës dB(A) Leq, T Ditë | Vlera kufi e zhurmës dB(A) Leq, T Mbrëmje | Raportimi në AKM | Periodi citeti |
|---|--|---|------------------|----------------|
| Automjete/kamiona ne hyrje te kantierit | 55 | 45 | 02.12.2023 | Çdo 6 muaj |

| | | | | |
|---------------------------------------|----|----|------------|------------|
| Kantier ndertimi | 55 | 45 | 02.12.2023 | Çdo 6 muaj |
| Mjedisi urban me i afert me kantierin | 55 | 45 | 02.12.2023 | Çdo 6 muaj |

Tabela e niveleve kufi:

- Shkarkimet në Ajër

- Të zbatohen nivelet kufi të shkarkimeve në ajër, referuar Ligjit Nr. 162/2014 “Për Mbrojtjen e Cilësisë së Ajrit në Mjedisi” dhe VKM Nr. 248, datë: 24.03.2003 “Për Miratimin e Normave të Përkohshme të Shkarkimeve në Ajër dhe Zbatimin e tyre”.
- Shkarkimet në ajër të jene brenda normave të lejuara, duke marre masa për reduktimin e tyre.
- Kantieri në të cilin emetohen lëndë grimcore në ajër, duhet të pajiset sipas mundësive teknike dhe mbi bazën e natyrës së procesit, me rrjeta uji / sisteme spërkatje / sisteme heqje pluhurash.
- Të bëhet monitorimi i nivelit të pluhurave në ajër, për mjediset: kantier ndërtimi dhe mjedisi urban më i afërt me kantierin çdo 6 muaj.

Tabela e niveleve kufi

| Ndotësi | Përqëndrimi | Raportimi AKM në | Periodiciteti |
|-------------------------------------|--|------------------|---------------|
| Lënda grimcore (PM _{2.5}) | 20-25 µg/m ³ | 02.12.2023 | Çdo 6 muaj |
| PM ₁₀ | 50 µg/m ³ , 40 µg/m ³ | 02.12.2023 | Çdo 6 muaj |

- Cilësia e ujrave

Parametrat që duhet të monitorohen

| Ndotësi | Përqëndrimi | Raportimi AKM në | Periodicite ti |
|-------------------|-------------|------------------|----------------|
| Lëndët në pezulli | 50 mg/l | 02.12.2023 | Çdo 6 muaj |

- Subjekti duhet të sjellë pranë AKM-së si më poshtë:

- Informacion në momentin e fillimit të punimeve
- Raportimin periodik për parametrat që do të monitorohen sipas datës së raportimit/ çdo 6 muaj.
- Informacion në përfundim të punimeve, lidhur me punimet rehabilituese të territorit përreth, shoqëruar edhe me foto.

- Afati i Vlefshmërisë

- Vendimi për VNM-në paraprake për projektin e propozuar është e vlefshme për aq kohë sa është i vlefshëm edhe dokumenti i miratimit të zhvillimit për projektin.
- Nëse projekti, që i është nënshtruar procesit të VNM-së, nuk fillon zbatimin në terren brenda 2 vjetëve nga data e miratimit të deklaratës mjedisore apo të vendimit për VNM-në paraprake, atëherë këto dokumente konsiderohen të pavlefshme dhe procesi i VNM-së fillon nga e para.

Në bazë të udhëzimit të MM dhe MF nr. 7938, datë 17.7.2014 “Për përcaktimin e tarifave dhe vlerave përkatëse për shërbimet që kryen Ministria e Mjedisit për procesin e VNM-së”, ky subjekt ka kryer pagesën 50.000 lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

ARTA DOLLANI

MINISTRI

MIRELA KUMBARO FURXHI

Konceptoi:

Pranoi:

Aneksi 1. Harta me Koordinatat



